FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 140

Tiranë – E martë, 25 tetor 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13860, datë 13.10.2022	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	17441
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 29.9.2022	Çështja Lacej dhe të tjerët kundër Shqipërisë *(kërkesa nr. 22122/08)*....	17441
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 201, datë 19.10.2022	Për delegimin e kompetencave.....	17444
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 483, datë 14.10.2022	Për një ndryshim në pikën "2, germa 'b'", të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 518, datë 21.12.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Berat–Kuçovë".....	17444
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 484, datë 14.10.2022	Për disa ndryshime në rregulloren "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura".....	17445
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 485, datë 14.10.2022	Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore.....	17446
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 700/7, datë 21.10.2022	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Rikonstruksion 'Rruga e Korpusit', Bashkia Shkodër.....	17446
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar "Sekret shtetëror" në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.....	17450
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 376 (2044), datë 19.5.2022	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Sokol Hoxha.....	17450

Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 431 (2376), datë 7.6.2022	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Irini Halili.....	17450
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 264 (1526), datë 21.4.2022	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Fatbardha Bajraktaraj.....	17450
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Marisel (Florin) Nuredini	17450
	Ndreqje gabimi në vendimin e ERRE-s nr. 220, datë 1.9.2022, "Për miratimin e ndryshimeve në rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 125, datë 20.9.2022.....	17451

DEKRET
Nr. 13860, datë 13.10.2022

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronja "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 6, nenit 20, dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Antigone Vebi Nuza
2. Driton Besnik Hoxhaj
3. Sedat Sali Kadriaj
4. Meral Gjeladin Celina
5. Luljeta Ali Celina (Hisari)
6. Kaltrina Lirim Gërmizaj
7. Elfije Vebi Sadikaj
8. Bledar Rexhep Nuza
9. Albana Adem Sufaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

SEKSIONI I TRETË
ÇËSHTJA LACEJ DHE TË TJERËT KUNDËR SHQIPËRISË
(kërkesa nr. 22122/08)

VENDIM

STRASBURG
29 shtator 2022

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet objekt i një rishikimi redaktues.

Në çështjen *Lacej dhe të tjerët kundër Shqipërisë*,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komision i përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar,*
Darian Pavli,
Frédéric Krenc, g*jyqtarë*
dhe Viktoriya Maradudina, *Zëvendësekretare e Përkohshme e Seksionit,*

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura, më 8 shtator 2022,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë.

PROCEDURA

1. Çështja nisi me një kërkesë kundër Shqipërisë paraqitur në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), më 5 prill 2008.

2. Kërkuesit u prezantuan nga z. B. Muslija, një avokat i cili e ushtron profesionin në Shkodër.

3. Qeveria shqiptare (Qeveria) u njoftua për kërkesën.

FAKTET

4. Detajet e kërkuesve dhe detajet që kanë lidhje me kërkesën paraqiten në tabelën bashkëlidhur.

5. Në thelb, kërkuesit u ankuan për kohëzgjatjen e tepërt të procedurave civile, veçanërisht të atyre përpara Gjykatës së Lartë.

LIGJI

I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6§1 TË KONVENTËS

6. Kërkuesit u ankuan se kohëzgjatja e procedurave civile në fjalë nuk respektonte parashikimin për "afat të arsyeshëm". Ata u mbështetën në nenin 6§1 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

"Neni 6§1

Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht,… nga [një] gjykatë…, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile…"."

A. Kërkuesit Sadik Llukacej dhe Adan Ulqinaku

7. Në lidhje me kërkuesit Sadik Llukacej dhe Adnan Ulqinaku, duke marrë në konsideratë materialet përpara saj, Gjykata thekson se këta kërkues nuk ishin palë në procedurat e brendshme në fjalë. Për këtë arsye, këta kërkues nuk mund të pretendojnë të jenë "viktimë" e shkeljes së të drejtave të tyre të parashikuara në Konventë, për shkak të procedurave që pretendohej të ishin të tejzgjatura. Në vijim rezulton se, sipas gjykimit të Gjykatës, ankesa nuk është në përputhje *ratione personae* me parashikimet e Konventës, sipas nenit 35§3(a), dhe duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35§4 të Konventës.

B. Tri kërkesat e tjera, Hasan Lacej, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë dhe Komuniteti Musliman i Shqipërisë

8. Për sa u përket kërkuesve: Hasan Lacej, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë (*Kisha Ortodokse);* Komuniteti Musliman i Shqipërisë (*Komuniteti Musliman)*, Gjykata thekson se ata kanë marrë pjesë në procedurat e brendshme në fjalë, duke përfshirë ato përpara Gjykatës së Lartë. Në lidhje me elementët që ka përpara saj, Gjykata konstaton se ankesa për pikat e ligjit u regjistrua më 26 janar 2010 përpara Gjykatës së Lartë, dhe pas pothuajse katër vjetëve pasiviteti, në vitin 2014, Gjykata e Lartë zhvilloi katër seanca dëgjimore për këtë çështje.

9. Në çështjet kryesore *Luli dhe të Tjerët kundër Shqipërisë* (nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, 1 prill 2014), *Mishgjoni kundër Shqipërisë* (nr. 18381/05, 7 dhjetor 2010), dhe *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë* (nr. 43391/18 dhe 17766/19, 12 tetor 2021), Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me problematika të ngjashme me ato në çështjen në fjalë.

10. Pasi shqyrtoi të gjithë materialin e paraqitur përpara saj, Gjykata nuk gjeti ndonjë fakt apo argument, i cili mund të justifikonte kohëzgjatjen e procedurave në nivel kombëtar, veçanërisht përpara Gjykatës së Lartë. Në lidhje me praktikën gjyqësore për këtë lëndë, Gjykata gjykon se në çështjen konkrete, kohëzgjatja e procedurave ishte e tepërt dhe nuk respektohej kërkesa për "afat të arsyeshëm".

11. Për këtë arsye, ankesa është e pranueshme dhe paraqet një shkelje të nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me tri ankesat e sipërpërmendura.

II. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

12. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.".

13. Duke marrë në konsideratë dokumentet përpara saj dhe praktikën e saj gjyqësore (shih veçanërisht, *Luli dhe të tjerët*, cituar më sipër, dhe *Mishgjoni*, cituar më sipër), Gjykata vendos se është e arsyeshme që të akordohen shumat e përcaktuara në tabelën bashkëlidhur për tre kërkuesit: Hasan Lacej, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë (*Kisha Ortodokse),* Komuniteti Musliman i Shqipërisë *(Komuniteti Musliman*).

14. Në vijim, Gjykata gjykon se është me vend që norma e interesit të papaguar duhet të mbështetet në normën margjinale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, së cilës duhet t'i shtohen tre për qind pikë.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. I deklaron ankesat e paraqitura nga tre kërkuesit: Hasan Lacej, Kisha Ortodokse dhe Komuniteti Musliman, të pranueshme, dhe kërkesat nga dy kërkuesit e tjerë, të papranueshme;

2. Gjykon se është shkelur neni 6§1 i Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave civile;

3. Gjykon:

a) Se Shteti i Paditur duhet t'u paguajë tre kërkuesve: Hasan Lacej, Kishës Ortodokse dhe Komunitetit Musliman, brenda tre muajve, shumat e paraqitura në tabelën bashkëlidhur, të cilat do të konvertohen në vlerën monetare të Shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b) Se, që prej përfundimit të periudhës së sipërpërmendur tremujore deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të paguhet për shumat e sipërpërmendura në një normë të barasvlershme me normën margjinale të huadhënies së Bankës

Qendrore Evropiane gjatë periudhë së paracaktuar plus tre për qind pikë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 29 shtator 2022, sipas rregullit 77 §§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Andreas Zünd
KRYETAR

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSSEKRETARE E PËRKOHSHME

SHTOJCË 1
KËRKESA E CILA NGRE ANKESA NË LIDHJE ME NENIN 6§1 TË KONVENTËS
(MOSZBATIM OSE ZBATIM I VONUAR I VENDIMEVE TË BRENDSHME)

Kërkesa nr. ..., data e paraqitjes	**Emri i kërkuesit Viti i lindjes, ku është e mundur**	**Emri i përfaqësuesit dhe vendndodhja**	**Fillimi i procedurave ose data e hyrjes në fuqi e Konventës për Shqipërinë (2 tetor 1996)**	**Përfundimi i procedurave**	**Kohëzgjatja në total Nivelet e juridiksionit**	**Shuma akorduar për dëmin jopasuror për kërkues (në euro)[1]**	**Shuma e akorduar për kostot dhe shpenzimet për kërkesë (në euro)[2]**
22122/08, 05/04/2008 (5 kërkues)	**Sadik LLUKACAJ** *1936* **Adnan ULQINAKU** 1940	Muslija Bashkim SHKODËR					
	Hasan LACEJ 1935 **KISHA ORTODOKSE AUTOQEFALE E SHQIPËRISË** **KOMUNITETI MUSLIMAN I SHQIPËRISË (MYFTINIA SHKODËR)**		26/01/2010	24/04/2014	4 vjet dhe 3 muaj, 1 nivel juridiksioni	1,200 Shumë e cila duhet të paguhet për secilin prej tre kërkuesve: Hasan Lacej, Kisha Ortodokse dhe Komuniteti Musliman	250 Shumë e cila duhet të paguhet për të tre kërkuesit së bashku: Hasan Lacej, Kisha Ortodokse dhe Komuniteti Musliman

[1] Plus çdo taksë që mund t'u tarifohet kërkuesve.
[2] Plus çdo taksë që mund t'u tarifohet kërkuesve.

URDHËR
Nr. 201, datë 19.10.2022

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Brendshëm, z. Andi Mahila, nga data 20.10.2022 deri më datë 21.10.2022.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm, z. Andi Mahila.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

VENDIM
Nr. 483, datë 14.10.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË PIKËN "2, GERMA 'b'", TË VENDIMIT TË KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 518, datë 21.12.2021, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME BERAT–KUÇOVË"

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 14.10.2022 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për një ndryshim në pikën 2, germa "b", të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 518, datë 21.12.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Berat–Kuçovë".

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Berat–Kuçovë (UK Berat–Kuçovë), me shkresën nr. 968 prot. datë 21.9.2022, me lëndë "Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik të sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Berat–Kuçovë" ka paraqitur pranë ERRU-së kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe rregullores së licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Berat–Kuçovë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.
3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Berat–Kuçovë me vendimin nr. 518, datë 21.12.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Berat–Kuçovë", me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtuese teknike e shoqërisë UK Berat–Kuçovë sh.a., znj. Evis Allajbe ka mbaruar studimet e larta në inxhinieri "Hidroteknikë", në vitin 2004.
5. ERRU-ja në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Berat–Kuçovë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë,

eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Berat–Kuçovë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën "2 b", të vendimit të KKRR-së nr. 518, datë 21.12.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Berat–Kuçovë", bëhet ndryshimi si më poshtë:

"Drejtues teknik: Evis Allajbe".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 484, datë 14.10.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR PROCEDURAT E DHËNIES DHE RINOVIMIT TË LICENCAVE PROFESIONALE PËR SUBJEKTET JURIDIKE E FIZIKE QË USHTROJNË VEPRIMTARI NË SEKTORIN E FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA"

Në zbatim të neneve 10, dhe 14 dhe 19, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator, duke qenë se riorganizimi i shoqërive UK në Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta (SKP-UK), sjell ulje të numrit të shoqërive aktuale njëkohësisht dhe uljen e të ardhurave në buxhetin e ERRU-së, si dhe duke pasur parasysh periudhën kalimtare të transferimit të tyre në SKP-UK:

VENDOSI:

1. Në aneksin nr. 5, të vendimit nr. 29, datë 8.12.2009, i Komisionit Kombëtar Rregullator "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, pas fjalëve të titullit, sipas kategorive të përcaktuara me VKM-në nr. 958, datë 6.5.2009... shtohet "për shoqëritë UK që ende nuk janë riorganizuar sipas VKM nr. 302, datë 11.5.2022".

2. Pas aneksit nr. 5, të vendimit nr. 29 datë, 8.12.2009, të Komisionit Kombëtar Rregullator "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, shtohet aneksi me nr. 5/1 me titull "Sipas kategorive të përcaktuara me VKM-në nr. 958, datë 6.5.2009 për shoqëritë të riorganizuara sipas VKM nr. 302, datë 11.5.2022.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë UK, shoqëritë subjekte me Kompetenca të Përbashkëta Ujësjellës-Kanalizime, si dhe të gjitha strukturat e ERRU-së.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

ANEKSI 5/1
PAGESAT PËR LICENCIM

1. Sipas kategorive të përcaktuara në vendim nr. 958, datë 6.5.2009, për shoqëritë të riorganizuara sipas VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022.

POPULLSIA E ZONËS SË MBULIMIT	PAGESAT			
	Kategoria A, grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik	**Kategoria B,** për përpunimin e ujit për konsum publik	**Kategoria C,** për largimin e ujërave të ndotura	**Kategoria D,** për përpunimin e ujërave të ndotura
50.000 - 100.000 banorë	60,000	60,000	60,000	60,000
100.000 - 150.000 banorë	80,000	80,000	80,000	80,000
150.000 - 200.000 banorë	120,000	120,000	120,000	120,000
200.000 – 500.000 banorë	150.000	150.000	150.000	150.000
Mbi 500.000 banorë	170.000	170.000	170.000	170.000
Ndryshim drejtuesi ligjor	40.000			
Ndryshim drejtuesi teknik	40.000			

Shënim. Operatorët do të bëjnë pagesat sipas tabelës së mësipërme në rast ndryshimi të kategorisë së shërbimit, të popullsisë në zonën e shërbimit apo ndryshim drejtuesi ligjor dhe/ose teknik.

VENDIM
Nr. 485, datë 14.10.2022

PËR MIRATIMIN E PËRQINDJES SË PAGESËS RREGULLATORE

Në mbështetje të nenit 10, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, të nenit 9, të "Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve Ujësjellës-Kanalizime" dhe rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit dhe Përpunimit të Ujërave të ndotura", duke qenë e nevojshme rritja e të ardhurave nga pagesa rregullatore për mbështetje financiare të ERRU-së, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të aplikohet koeficienti 0.65% mbi të ardhurat e parashikuara për llogaritjen e pagesës rregullatore për kontratat e reja në vijim.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike.

3. Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 22, datë 14.11.2014, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2023.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

KËRKESË
Nr. 700/7, datë 21.10.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Rikonstruksion 'Rruga e Korpusit', Bashkia Shkodër".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Shkodër.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për

interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit "truall" bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Shkodër, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 8 116 072 (tetë milionë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e dy) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA EMËRORE E PRONAREVE, PASURI TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E TË CILËVE PREKEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION RRUGA E KORPUSIT"

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE								VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				
												Truall				
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m^2)	Truall (m^2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	A	B	C	Ç	D	F		G	H	I	J	K	L	M	N	O
1	Adriana Anila Apolonja Arben Brikena Cecile Eduard Fatime Leonard Ludmilla Mariza Meri Niko Rozina Silvana	Halim Tonin Çezar Halim Çezar Baldazar Sander Halim Sandër Halim Ndoc Sandër Pashko Pashko Tonin	Demaliaj (Dumi) Mjeda Mjeda Dumi Mjeda Mjeda Kraja Dumi Kraja Papa (Dumi) Mjeda Kraja Mjeda Mjeda Mjeda	Shkodër	8592	9/482	TRUALL	3156	3156	22	245	664	12223	8 116 072	8 116 072	sipas pjesëve takuese në vërtetimin hipotekor 1. Adriana Halim Demaliaj (Dumi) ka 36/864 pjesë, me vlerë 338169.97 lekë. 2. Anila Tonin Mjeda ka 72/864 pjesë me vlere 676339.33. 3.Apolonja Çezar Mjeda ka 120/864 pjesë me vlere 1127232.22 lekë 4.Arben Halim Dumi ka 120/864 pjesë me vlerë 1127232.22 lekë 5. Brikena Çezar Mjeda ka 120/864 pjesë me vlerë 1127232.22 lekë. 6. Cecile Baldazar Mjeda ka 48/864 pjesë me vlerë 450892.88 lekë 7. Eduard Sander Kraja ka 48/864 pjesë me vlerë 450892.88 lekë. 8. Fatime Halim Dumi ka 36/864 pjese me vlerë 338169.97 lekë. 9. Leonard Sandër Kraja ka 48/864 pjesë me vlerë 450892.88 lekë. 10. Ludmilla Halim Papa (Dumi) ka 36/864 pjesë me vlerë 338169.97 lekë 11.Mariza Ndoc Mjeda ka 48/864 pjesë me vlerë 450892.88 lekë. 12. Meri Snder Kraja ka 48/864 pjesë me vlerë 450892.88 lekë. 13.Niko Pashko Mjeda ka 48/864 pjese me vlere 450892.88 leke. 14. Rozina Pashko Mjeda 48/864 pjese me vlere 450892.88 leke. 15. Silvana Tonin Mjeda

														ka 72/864 pjesë me vlerë 450892.88 lekë.
2	PPV	Shkodër	8592	9/571	TRUALL	174.38	174.38	31	90	38.6	0	0	0	
3	Shteti	Shkodër	8592	9/542	TRUALL	239.99	239.99	30	167	67	0	0	0	
4	Shteti	Shkodër	8592	9/572	TRUALL+ NDËRTESË	346	346	27	124	31.5	0	0	0	
5	Shteti	Shkodër	8592	9/556	TRUALL	2551.82		36	51	2040.40	0	0	0	
6	Shteti	Shkodër	8592	9/539	TRUALL	1962.09	1962.09	13	46	23.4	0	0	0	
7	Shteti	Shkodër	8592	9/286	TRUALL	17106.48	17106.48	18	213	451.7	0	0	0	Kufizim. Ka 27 ndërtime pa leje
8	Shteti	Shkodër	8592	9/564	TRUALL	1474.48	1474.48	18	218	4.3	0	0	0	EKB është pronare e ndërtesës nr. 9/502, e cila ngrihet mbi pasurinë truall me nr. 9/502
9	Shteti	Shkodër	8592	9/566	RRUGE	329.93	329.93	36	92	26.6	0	0	0	
10	Shteti	Shkodër	8592	9/593	TRUALL	491.56	491.56	21	234	9.2	0	0	0	
11	Shteti	Shkodër	8592	9/557	RRUGE	825.29		30	66	730.7	0	0	0	
	Vlera paraprake e shpronësimit												**8 116 072**	

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR "SEKRET SHTETËROR" NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror"', të ndryshuar; si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret Shtetëror"', Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror" në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, i mbledhur më datë 14.10.2022, vendosi të deklasifikojë informacionet e klasifikuara "Sekret shtetëror", si më poshtë:

1. Deklasifikohen plotësisht informacionet (dosjet) e klasifikuara "Sekret shtetëror", si më poshtë:

Fondi 14/APSTR, viti 1987

Dosjet nr. 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 20, 21, 22, 23, 24, 28, 30, 31, 32, 34, 35, 37, 38, 39, 42, 43, 44, 45, 48, 49, 50, 51, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 60, 61, 62, 65, 67. Niveli i klasifikimit, "Sekret". Dosja nr. 69. Niveli i klasifikimit, "T. Sekret". Dosjet nr. 71, 72, 74, 76, 77, 79, 81, 84, 89, 91, 92, 93, 94, 95, 98, 99, 100, 102, 103, 104, 105, 406, 108, 109, 110, 111, 112, 113, 114, 115, 117, 119, 120, 121, 123, 125, 126, 129, 130, 131, 132, 134, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 149, 152, 153, 154, 157, 158, 159, 164, 165, 166, 167, 168, 169, 170, 171, 172, 173, 174, 175, 176, 177, 178, 179, 181, 182, 184, 185, 186, 187, 188, 189, 190, 192, 193, 194, 195, 197,199, 200, 201, 203, 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 222, 223, 224, 225, 226. Niveli i klasifikimit, "Sekret". Dosja nr. 227. Niveli i klasifikimit "T. sekret". Dosjet nr. 228, 229, 230, 231, 232, 233, 234, 235, 236, 237, 239, 240, 241, 242, 243, 244, 246, 247, 248, 249, 250, 251, 252, 254, 256, 257, 259, 260, 261, 262, 263, 264, 265, 266, 267, 268, 269, 270, 272, 273, 274, 275, 281, 283, 284, 285, 286, 287, 288, 289, 290, 291, 292, 293, 294, 295, 296, 297, 298, 299, 303, 304, 305, 306, 309, 315, 316, 318, 320, 322, 323, 324, 328, 332, 333, 334, 336, 338, 339, 340, 341, 342, 343, 344. Niveli i klasifikimit, "Sekret".

2. Një kopje e bibliografisë t'i dërgohet DSIK-së, si dhe për botim në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 376 (2044), datë 19.5.2022, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Sokol Fasli Hoxha, i datëlindjes 18.1.1974, dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të Institutit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Shënkoll, Lezhë.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 431 (2376), datë 7.6.2022, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Irini Indrit Halili, e datëlindjes 10.10.2005, lindur në Patra, Greqi dhe vendosjen e saj në kujdestarinë ligjore të nënës së saj, Loreta Tomë Halili.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 264 (1526), datë 21.4.2022, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Fatbardha Bajraktaraj, e datëlindjes 17.4.1976, lindur dhe banuese në Postribe, Shkodër, si dhe vendosjen e saj në kujdestarinë ligjore të kërkueses Pranvera Bajraktaraj.

KËRKESË

Shtetasja Sabrije Nuredini kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, shpalljen si të zhdukur të shtetasit Marisel (Florin) Nuredini, i datëlindjes 26.7.1981, lindur dhe banues në fshatin Ostren, Njësia Administrative Ostren, Bashkia Bulqizë.

KËRKUES
Sabrije Nuredini

NDREQJE GABIMI

Në vendimin e ERRE-s nr. 220, datë 1.9.2022 "Për miratimin e ndryshimeve në rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 125, datë 20.9.2022, bëhet korrigjimi si më poshtë:

Në nenin 4, "Licencat", pika 4:

Ishte: Për aq sa e lejon legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë, nuk do të kërkohet aplikimi për licencim për tregtimin e energjisë elektrike ose furnizimin me energji elektrike, në rast se një shoqëri ka një licencë të lëshuar nga një autoritet rregullator i një vendi tjetër Palë Kontraktore e Komunitetit të Energjisë/një Shteti Anëtar të Bashkimit Evropian ose një vend tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, për njohjen reciproke të licencave ndërmjet ERE-s dhe autoritetit përkatës rregullator, si dhe me kusht që ato të dorëzojnë në ERE licencën e përkthyer dhe noterizuar, si dhe informacionin e përcaktuar në nenin 9(1) dhe 9(2), germa "c", të këtyre rregullave.

Bëhet: Për aq sa e lejon legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë, nuk do të kërkohet aplikimi për licencim për tregtimin e energjisë elektrike ose furnizimin me energji elektrike, në rast se një shoqëri ka një licencë të lëshuar nga një autoritet rregullator i një vendi tjetër Palë Kontraktore e Komunitetit të Energjisë/një shteti Anëtar të Bashkimit Evropian ose një vend tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, për njohjen reciproke të licencave ndërmjet ERE-s dhe autoritetit përkatës rregullator, si dhe me kusht që ato të dorëzojnë në ERE licencën e përkthyer dhe noterizuar, si dhe dokumentacionin e përcaktuar në shtojcën 1/K të këtyre rregullave.

Në nenin 8, "Paraqitja e aplikimit", pika 3:

Ishte: Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose fotokopje e noterizuar dhe një kopje elektronike në CD, USB ose me *e-mail* në adresën zyrtare të ERE-s, ndërsa vërtetimet dhe deklaratat nga organet e tjera duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.

Bëhet: Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose kopje e njësuar me dokumentin origjinal ose me nënshkrim/vulë elektronike, në rastin kur këto aplikohen. Vërtetimet dhe deklaratat duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 (një) muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.

Në shtojcën 1, "Formati i aplikimit", germa "b"

Në pikën 6 të tabelës hiqet fjala "Funksioni".

Në shtojcën 1/D, pika 6, "Në rastet e aplikimit për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, bashkëlidhur duhet depozituar, gjithashtu":

Ishte: Bilanci financiar i 3 (tre) vjetëve të fundit/ose kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë e krijuara rishtazi), të audituar (kur kjo kërkohet nga ligji) dhe/ose dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe mbështetjen financiare (financim i vetë aplikuesit, kredi ose garanci bankare, donacion etj.) për ushtrimin e veprimtarisë, sipas llojit të aplikimit, bazuar në këtë dokumentacion.

Bëhet: Bilanci financiar i 3 (tre) vjetëve të fundit/ose kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë e krijuara rishtazi), të audituar (kur kjo kërkohet nga ligji) dhe/ose dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe mbështetjen financiare (financim i vetë aplikuesit, kredi ose garanci bankare, donacion etj.) për ushtrimin e veprimtarisë, sipas llojit të aplikimit, bazuar në këtë dokumentacion. (në rastin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, mbështetja financiare duhet të garantojë të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi).

Në shtojcën 1/E, "Në rastet e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, bashkëlidhur duhet depozituar gjithashtu":

Numeracioni ishte: 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19.

Numeracioni bëhet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.

Pika 6, sipas numeracionit të ri, ishte: Bilanci financiar i 3 (tre) vjetëve të fundit/ose kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë e krijuara rishtazi), të audituar (kur kjo kërkohet nga ligji) dhe/ose dokumente, që vërtetojnë aftësinë dhe mbështetjen financiare (financim i vetë aplikuesit, kredi ose garanci bankare, donacion etj.) për ushtrimin e veprimtarisë, sipas llojit të aplikimit, bazuar në këtë dokumentacion.

Bëhet: Bilanci financiar i 3 (tre) vjetëve të fundit/ose kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë e krijuara rishtazi), të audituar (kur kjo kërkohet nga ligji) dhe/ose dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe mbështetjen financiare (financim i vetë aplikuesit, kredi ose garanci bankare, donacion etj.) për ushtrimin e veprimtarisë, sipas llojit të aplikimit, bazuar në këtë dokumentacion. (në rastin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, mbështetja financiare duhet të garantojë të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin Tuaj,

Me respekt,

KRYETAR
Petrit Ahmeti

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 140
Datë: 2022/10/25 13:39:15
4eacf517-f5d9-4b84-b132-1d9ec8c9e774

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë